

VENDIM
Nr.1482, datë 12.11.2008

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, të programeve të studimit, të ciklit të dytë, si më poshtë vijon:

a) Në inxhinieri mjedisi, me profile:

- Trajtim uji;
- Energjetikë.

Në përfundim të këtij programi do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri mjedisi, profili trajtim uji;
- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri mjedisi, profili energjetikë.

b) Në “Inxhinieri ndërtimi”, profili gjeoteknik, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri ndërtimi, me profil gjeoteknikë.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Kuota e pranimeve në programet e mësipërme të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2008-2009, të jenë, si më poshtë:

- | | |
|--|-----|
| i) Inxhinieri mjedisi | 50; |
| ii) Inxhinieri ndërtimi, profili gjeoteknikë | 25. |

5. Universiteti Politeknik i Tiranës shpërndan kuotat e vëna në dispozicion të tij, në masën jo më pak se 30%, për studentët, që kanë përfunduar të paktën ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70 %, për ata që i kanë përfunduar këto studime pranë tij. Në rastet kur nuk ka kandidatë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, që plotësojnë kriteret, atëherë Universiteti Politeknik i Tiranës ka të drejtë të plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, që janë diplomuar në të.

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, të përcaktuara nga njësitet kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës, bëhen publike.

6. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, të jetë sipas pikës 6.b.V të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimet në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si dhe për tarifat e shkollimit për këto programe, të miratuara për vitin akademik 2008-2009”.

7. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si: të verbër, të shurdhër, invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentët me aftësi të kufizuara, fëmijët romë apo fëmijët e policëve, të rënë ose të plagosur, për shkak të detyrës, të ish-të përndjekurve politikë, që do të fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi, të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, do të paguajnë 50% të tarifës së shkollimit.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

9. Në çdo program studimi, në ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët e shkëlqyer nga cikli i parë dhe nga cikli i dytë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit, për vitin akademik pasardhës.

10. Kuotat e pranimeve në programet e studimit të ciklit të dytë, sipas pikës 4 të këtij

vendimi, që mbeten të parealizuara, rishpërndahen sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha